

Bazuar në nenin 7 paragrafi 4 të Ligjit për organizatat turistike (“Fleta zyrtare e RMZ” nr. 11/04, 46/07, “Fleta zyrtare e MZ” nr. 73/10, 40/11, 45/14, 42/17 dhe 27/19), nenit 38 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen lokale (“Fleta zyrtare e MZ” nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22 dhe 84/22) dhe nenit 58 paragrafi 1 pika 2 e Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fleta zyrtare e MZ – Dispozitat e komunave” nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në seancën e mbajtur me datë 21.12.2022. bie

VENDIM PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET NË VENDIMIN PËR THEMELIMIN E ORGANIZATËS TURISTIKE TË KOMUNËS SË ULQINIT

Neni 1.

Me anë të këtij vendimi ndryshohet Vendimi për themelimin e Organizatës Turistike të Komunës së Ulqinit (“Fleta zyrtare e MZ – Dispozitat e komunave” nr. 05/07).

Neni 2.

Neni 2 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Organizata turistike funksionon me emrin: Organizata Turistike e Komunës së Ulqinit.

Selia e organizatës turistike është në Ulqin.

Organizata turistike ka statusin e personit juridik.

Organizata turistike fiton statusin e personit juridik ditën e regjistrimit në Regjistrin e organizatave turistike.

Neni 3.

Neni 4 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Anëtarët e detyrueshëm të Organizatës turistike janë të gjithë personat fizik dhe juridikë të cilët kanë selinë apo njësinë e tyre organizative në territorin e komunës së Ulqinit dhe realizojnë të ardhura duke ushtruar veprimtari turistike dhe hoteliere si dhe aktivitete tjera që lidhen drejtpërdrejt me turizmin.

Në Organizatën turistike në mënyrë vullnetare mund të anëtarësohen edhe persona tjerë fizikë dhe juridikë nga territori i komunës së Ulqinit të cilët nuk janë anëtarë të Organizatës turistike në bazë të paragrafit 1 të këtij neni.

Në lidhje me kërkesën e personave nga paragrafi 2 i këtij neni vendos Kuvendi i Organizatës.

Neni 4.

Neni 5 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Përfaqësuesit sipërmarrës në Kuvendin e Organizatës turistike, pjesëmarrja e të cilëve përcaktohet sipas pjesëmarrjes së tyre në të ardhurat e organizatës turistike dhe rëndësinë për zhvillimin e përgjithshëm të turizmit janë:

- Përfaqësues hotelier
- Përfaqësues të agjensive turistike
- Përfaqësues të sipërmarrjeve dhe restauranteve
- Përfaqësues të akomodimit privat
- Përfaqësues tjerë të subjekteve ekonomike të turizmit (kampe, prodhues suvenirash, përfaqësues të guidave turistike, shërbime Wellness, shoqëri dhe klube turistike).

Komuna në cilësinë e themeluesit përcakton numrin e përfaqësuesve të saj në Kuvendin e organizatës turistike, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10.

Me propozim të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës zgjedh përfaqësuesit e komunës në Kuvendin e organizatës turistike.

Neni 5.

Neni 6 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Aktivitetet e Organizatës turistike janë:

- 1) përmirësimi dhe promovimi i vlerave burimore të zonës së komunës për të cilën është themeluar;
- 2) mbledhja dhe përditësimi i të dhënave për ofertën turistike të komunës dhe publikimi i tyre në faqen e saj të internetit;
- 3) pjesëmarrja në zbatimin e projekteve për zhvillimin dhe diversifikimin e ofertës turistike;
- 4) krijimi i kushteve për aktivizimin e burimeve turistike në territorin e komunës;
- 5) bashkëpunimi me persona juridikë, persona fizikë, shoqata dhe organizata joqeveritare objekti i veprimtarisë së të cilave është turizmi ose aktivitete plotësuese dhe hotelieria për të rënë dakord, përcaktuar dhe zbatuar politikën e zhvillimit të turizmit dhe përmirësimin e kushteve të qëndrimit të turistëve në territorin e komunës;
- 6) realizimi i materialeve turistike-propaganduese dhe informative;
- 7) nxitja, koordinim dhe organizimi i manifestimeve kulturore, artistike, argëtuese, ekonomike, sportive dhe manifestime tjera të cilat kontribuojnë në pasurimin e ofertës turistike;
- 8) ofrimi i informacionit mysafirëve për disponueshmërinë e akomodimit të objekteve hotelierike parësore dhe plotësuese, objekteve të hotelierisë për ofrimin e shërbimeve të përgatitjes dhe shërbimit të ushqimit, pijeve dhe objekteve akomoduese private, manifestimeve kulturore, ngjarjeve dhe informacione të tjera për shërbimet turistike në territorin e komunës;

- 9) ofrimi i informacionit për orarin e punës së institucioneve shëndetësore, bankare, postës, tregtisë dhe informacione të tjera të nevojshme për qëndrimin e turistëve;
- 10) ndërmjetësimi dhe dhënia e ndihmës gjatë rezervimeve dhe dhënia e informacioneve për objektet akomoduese nëse nuk ka agjensi turistike të regjistruar në destinacionin turistik për të cilin është themeluar organizata turistike;
- 11) dorëzimin e lajmërimit dhe çlajmërimit të qëndrimit në përputhje me ligjin;
- 12) nxitja e aktivizimit të zonave të komunës të cilat nuk janë ose janë jomjaftueshëm të përfshira në xhiron turistike;
- 13) nxitja dhe organizimi i veprimeve që synojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e zonës turistike, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore;
- 14) zbatimi i programit të veprimtarisë për qëndrimin e grupeve studimore dhe gazetarëve në sferën e veprimtarisë së tyre;
- 15) mbajtja e evidencës me qëllim kontrollin e dhënies dhe shfrytëzimit të njësive akomoduese në vikend shtëpiza, në bashkëpunim me organet e administratës lokale dhe realizimi i raporteve që i dorëzohen Ministrisë së paku çdo dy muaj;
- 16) organizimi i zyrave informative turistike në vendet turistike që vlerësohen si të nevojshme;
- 17) mbledhja dhe përpunimi i të dhënave (ditore, javore dhe mujore) për xhiron turistike (numrin e turistëve dhe numrin e netëqëndrimeve) dhe strukturën përkatëse në territorin e komunës si dhe përgatitjen e raportit mujor të xhiros turistike (numri i turistëve dhe numri i netëqëndrimeve) për nevojat e organit kompetent për realizimin e statistikave dhe Organizatës Kombëtare Turistike;
- 18) mbajtjen e evidencës për mbledhjen e taksës së vendbanimit, taksës së ekskurzionit, taksës turistike dhe taksës së anëtarësimit;
- 19) vlerësimi i xhirove turistike të pambuluar në nivel komunal;
- 20) bashkëpunimi me autoritetet komunale me qëllim të miratimit dhe zbatimit të masave lokale për përmirësimin e kushteve të qëndrimit të turistëve në territorin e komunës;
- 21) bashkëpunimi me shoqatat vendore dhe organizatat joqeveritare në fushën e turizmit dhe hotelierisë dhe aktivitetet e tyre plotësuese;
- 22) bashkëpunimi me organizatat e tjera turistike vendore në Mal të Zi;
- 23) kryerja e anketave dhe hulumtimeve tjera me qëllim përcaktimin e vlerësimit të cilësisë së produktit turistik në territorin e komunës;
- 24) përgatitja e raporteve dhe informacioneve për nevojat e Organizatës Kombëtare Turistike;
- 25) paraqitja e planit vjetor për përmirësimin dhe zhvillimin e turizmit Organizatës Kombëtare Turistike për shqyrtim dhe miratim;
- 26) kryerja e punëve tjera me qëllim të promovimit të produktit turistik në territorin e komunës;
- 27) bashkëpunimi me organizata të njëjta ose të ngjashme jashtë Malit të Zi.

Neni 6.

Neni 8 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Organizata turistike gjeneron të ardhura nga burimet e mëposhtme:

- 1) kontributi i anëtarësimit;
- 2) taksa e banimit, në përputhje me ligj të veçantë;
- 3) taksa e ekskursionit;
- 4) taksa turistike;
- 5) fondet e komunës dhe buxhetit të Malit të Zi, në bazë të programeve të veçanta;
- 6) kontributet (donacionet) vullnetare;
- 7) kreditë;
- 8) fondet e fituara përmes partneriteteve dhe pjesëmarrjeve strategjike;
- 9) nga burime të tjera, në përputhje me ligjin (shitja e suvenirëve, kryerja e veprimtarive botuese dhe online – shitja nëpërmjet internetit).

Përveç të ardhurave nga shitja e suvenirëve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, organizata turistike mund të gjenerojë të ardhura duke kryer veprimtari botuese dhe veprimtari të tjera që synojnë arritjen e qëllimeve të saj, në përputhje me ligjin.

Organizata turistike është e detyruar që të ardhurat e gjeneruara nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni ti përdorë në përputhje me qëllimin e tyre, programin vjetor të punës dhe planin financiar vjetor.

Organizata turistike mund të kryejë veprimtari ekonomike dhe veprimtari të tjera nëse është e regjistruar në Regjistrin qendror të subjekteve ekonomike për të kryer atë veprimtari.

Neni 7.

Në nenin 11, fshihet paragrafi 2.

Neni 8.

Neni 12 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Kuvendin e organizatës turistike e përbëjnë përfaqësuesit e Organizatës Kombëtare Turistike, përfaqësuesit e anëtarëve të organizatës turistike vendore dhe përfaqësuesit të organeve kompetente të vetëqeverisjes lokale si anëtarë të detyrueshëm, si dhe përfaqësues të anëtarëve të tjerë të organizatës turistike lokale të cilët anëtarësohen vullnetarisht.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 (katër) vjet.

Neni 9.

Neni 13 paragrafi 1 pika 7 i Vendimit ndryshohet si vijon:

7. Miraton planin financiar dhe pasqyrën financiare vjetore të Organizatës turistike dhe zyrave informative turistike;

Neni 10.

Neni 14 paragrafi 1 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Bordi ekzekutiv është organi ekzekutiv i Kuvendit të Organizatës turistike dhe për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Organizatës turistike.

Neni 14 paragrafi 2 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Bordi ekzekutiv ka kryetarin dhe gjashtë anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Organizatës turistike.

Neni 11.

Neni 15 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Bordi ekzekutiv kryen detyrat e përcaktuara me ligj, me këtë Vendim dhe me Statutin e Organizatës turistike, përkatësisht:

1. Zbaton vendimet dhe përfundimet e Kuvendit të Organizatës;
2. I propozon Kuvendit udhëzimet bazë, programin vjetor të punës dhe planin financiar të Organizatës deri në fund të nëntorit të vitit aktuar;
3. I paraqet Kuvendit raportin për realizimin e Programit të punës dhe veprimtarisë financiare të Organizatës;
4. Menaxhon pasurinë e Organizatës turistike në përputhje me ligjin, statutin e organizatës dhe rregulloreve tjera.
5. Emëron drejtorin e Organizatës turistike vendore dhe drejtuesit e njësive organizative në bazë të konkursit publik;
6. Vendosi për kërkesën e personave fizikë për anëtarësim vullnetar në Organizatë;
7. Emëron dhe shkarkon në bazë të shpalljes publike drejtuesin e zyrës informative turistike;
8. Aprovon propozimin e Statutit;
9. Përgatit propozime dhe jep mendime për çështjet që vendos Kuvendi i Organizatës;
10. Vendosi për përdorimin e mjeteve për ndërtimin, përshtatjen dhe prokurimin e objekteve afariste në pajtim me Planin financiar;
11. Miraton Rregulloren e punës së bordit ekzekutiv;
12. Miraton akte të përgjithshme që nuk miratohen nga Kuvendi i Organizatës;
13. Nxiti bashkëpunimin me organizatat dhe subjektet tjera turistike që janë të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi në xhiron turistike;
14. Kryen punë të tjera të cilat janë të përcaktuara me rregullore dhe akte të tjera të përgjithshme.

Neni 12.

Neni 18 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Kryetari i Organizatës:

1. Përfaqëson Organizatën;
2. Mbledh dhe kryeson Kuvendin e Organizatës;
3. Organizon, koordinon dhe harmonizon punën me aktivitetet e Organizatës në përputhje me ligjin, këtë Vendim, Statutin dhe Programin e punës së Organizatës;

4. Kujdeset për kryerjen e ligjshme dhe në kohë të detyrave të Organizatës;
5. Inicon dhe kujdeset për bashkëpunimin e Organizatës me organizatat tjera turistike dhe subjekte tjera me interes të përbashkët;
6. Kujdeset për përgatitjen e seancave të Kuvendit të Organizatës;
7. Nënshkruan vendimet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Organizatës;
8. Kryen punë të tjera të përcaktuara me Statutin dhe aktet tjera të Kuvendit të organizatës turistike.

Mandati i Kryetarit të Organizatës turistike zgjat aq sa mandati i Kryetarit të Komunës.

Neni 13.

Neni 23 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Kuvendi i Komunës së Ulqinit në emër të themeluesit ka këto të drejta dhe detyrime:

- Jep pëlqimin për Statutin e Organizatës turistike;
- Jep pëlqimin për programet e punës dhe zhvillimit të Organizatës turistike dhe masat për zbatimin e tyre;
- Shqyrton, vlerëson dhe jep pëlqimin për raportin e Organizatës turistike për zbatimin e programit të punës dhe zhvillimit;
- Jep pëlqimin për planin financiar të Organizatës turistike;
- Jep pëlqimin për pasqyrën financiare të Organizatës turistike;
- Jep pëlqimin për ndryshimet e statusit, ndryshimet në aktivitetet dhe selinë e Organizatës turistike;
- Kryen edhe punë të tjera me rëndësi për arritjen funksionale të themeluesit.

Neni 14.

Për të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike dhe shprehimisht me këtë Vendim zbatohet Ligji për organizatat turistike.

Neni 15.

Statuti i Organizatës turistike të Ulqinit dhe aktet e tjera të përgjithshme do të ndryshohen në përputhshmëri me këtë Vendim brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 16.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Fletoren zyrtare të Republikës së Malit të Zi – Rregullorja e komunave”.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02-016/22-553-3
Ulqin, më 21.12.2022

KRYETAR
Ardijan Mavriq